




<p align="center"><b>RESOLUTION OF THE SOLE SHAREHOLDER OF THE COMPANY "BERALB" SHA ON:</b></p>	<p align="center"><b>VENDIM I AKSIONARIT TË VETËM TË SHOQËRISË "BERALB" SHA MBI:</b></p>
<p>• <b>"The approval of the Financial Statements of the company "BERALB" SHA for the year 2019, based on the independent audit report prepared by the external auditor - MAZARS SHPK with fiscal ID No. K32123006W.</b></p>	<p><b>"Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë "BERALB" SHA për vitin 2019, bazuar në raportin e pavarur të auditimit, hartuar nga audituesi i jashtëm, MAZARS SHPK me Nr. NUIS K32123006W</b></p>
<p>The Sole Shareholder considered, today on <b>17.07.2020</b> the Agenda of the Meeting and the relevant documentation, in relation to the aforementioned issues.</p>	<p>Aksionari i Vetëm konsideroi sot më datë <b>17.07.2020</b>, axhendën e Mbledhjes dhe dokumentacionin përkatës, në lidhje me çështjet e sipërcituara.</p>
<p>In vlew of the above, based on the Statute of the company, the Sole Shareholder,</p>	<p>Për sa më sipër, bazuar në Statutin e shoqërisë, Aksionari i Vetëm,</p>
<p align="center"><b><u>DECIDED:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>To approve the Financial Statements of "BERALB" SHA for the financial year 2019 based on the Independent audit report prepared by the external auditor - MAZARS SHPK with fiscal ID No. K32123006W.</b></li> <li><b>Considering that the year 2019 has resulted in a financial loss, the company shall not distribute any dividend.</b></li> </ol>	<p align="center"><b><u>VENDOSI:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë "BERALB" SHA për vitin 2019, bazuar në raportin e e pavarur të auditimit, hartuar nga audituesi i jashtëm, MAZARS SHPK me Nr. NUIS K32123006W.</b></li> <li><b>Duke konsideruar që viti 2019 ka rezultuar me humbje financiare, shoqëria nuk mund të shpërndajë fitim/dividend.</b></li> </ol>

**SOLE SHAREHOLDER OF THE COMPANY**


**"BERALB" SHA**

**"NESKO METAL SANAYI VE TICARET**

**ANONIM SIRKETI"**

Represented by Mr. Selim Sevgen

*Selim Sevgen*



[signature] [Beralb - Seal]

**AKSIONARI I VETËM I SHOQËRISË**

**"BERALB" SHA**

**"NESKO METAL SANAYI VE TICARET**

**ANONIM SIRKETI"**

Përfaqësuar nga Z. Selim Sevgen



[nënshkrimi] [vula - Beralb]

*G - Selim*

Vat number - {6310550894}

Nr. TVSH - {6310550894}

**DECISION  
OF THE BOARD OF DIRECTORS  
OF THE COMPANY  
NESKO METAL SANAYI VE TICARET  
ANONIM SIRKETI**

**VENDIM  
I BORDIT TË DREJTORËVE  
TË SHOQËRISË  
NESKO METAL SANAYI VE TICARET  
ANONIM SIRKETI**

At 10:00 (local time) on 16.07.2020 in the address Uso Center, Büyükdere Cad. No:245 Kat:11 Maslak/Istanbul, is regularly convoked a meeting ("Meeting") of the board of directors ("Board") of the company "NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI" (the "Company") in the quality of the sole shareholder ("Sole Shareholder") of "BERALB" SHA, a joint stock company organized and existing under the laws of the Republic of Albania with Fiscal No. K12107002A ("BERALB").

Sot më datë 16.07.2020 në orën 10:00 (ora lokale) në adresën: Buyukdere Cad. USO Center No: 245, Kat 11, Maslak-Stamboll, është mbledhur rregullisht Mbledhja e Bordit të Drejtorëve të shoqërisë "NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI", në cilësinë e Aksionarit të Vetëm (Aksionari i Vetëm) të "BERALB" SHA, një shoqëri aksionare e themeluar dhe organizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me NIPT nr. K12107002A ("BERALB").

The Meeting was convoked by Mr. Kebling ZHA in the quality of a director of the Company. According to the Statute of the Company he is authorized to convoke the Meeting.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve u thirr nga Kebling ZHA në cilësinë e anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë. Sipas statutit të shoqërisë ai është i autorizuar të thërrasë mbledhjen.

The agenda of the Meeting is the following:

Axhenda e takimit është si vijon:

- Authorization of Mr. Selim Sevgen to represent the Company "NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI", in the Assembly of Shareholders meeting of the Albanian

- Autorizimi i z. Selim Sevgen për përfaqësimin e "NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI", në mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë shqiptare

*[Handwritten signatures and initials in blue ink at the bottom of the page]*

<p>company "BERALB" SHA, having the following agenda:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• The approval of the Financial Statements of the company "BERALB" SHA for the year 2019, based on the independent audit report, prepared by the external auditor - MAZARS SHPK with fiscal ID No. K32123006W.</li> </ul> <p>The members present in the Meeting considered the Agenda of the Meeting and the relevant documentation, in relation to the aforementioned issues.</p> <p>In view of the above, based on the Statute of the Company, the Board, unanimously,</p> <p style="text-align: center;"><b>DECIDED:</b></p> <p>To authorize <b>Mr. Selim Sevgen</b>, Turkish citizen, born in Malatya, on 27.03.1970, holder of passport No. U00242978 ("Assignee"), to represent the Company "NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI", in the Assembly of Shareholders meeting of BERALB, having the following agenda:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. The approval of the Financial Statements of the company "BERALB" SHA for the year 2019, based on the independent audit report prepared by the external auditor - MAZARS SHPK with fiscal ID No. K32123006W.</li> </ol>	<p>"BERALB" sha, me rendin e ditës si më poshtë vijon:</p> <p><b>Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë "BERALB" SHA për vitin 2019, bazuar në raportin e pavarur të auditimit, hartuar nga audituesi i jashtëm, MAZARS SHPK me Nr. NUIS K32123006W</b></p> <p>Anëtarët prezentë në mbledhje konsideruan rendin e ditës së mbledhjes dhe dokumentacionin përkatës, në lidhje me çështjet e lartpërmendura.</p> <p>Për sa më sipër, në bazë të statutit të shoqërisë, Bordi unanimisht,</p> <p style="text-align: center;"><b>VENDOSI:</b></p> <p>Të autorizojë <b>Z.Selim Sevgen</b>, shtetas Turk, lindur në Malatya, më 27.03.1970, mbajtës i pasaportës Nr. U00242978 ("Përfaqësuesi") për përfaqësimin e "NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI", në mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë shqiptare "BERALB" sha, me rendin e ditës si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë "BERALB" SHA për vitin 2019, bazuar në raportin e pavarur të auditimit, hartuar nga audituesi i jashtëm, MAZARS SHPK me Nr. NUIS K32123006W</b></li> </ol>
---	--

**2. Considering that the year 2019 has resulted in a financial loss, the company shall not distribute any dividend.**

The Assignee is given all competences in regard to the aforementioned decision-making process of the company BERALB SHA.

[Signature follows]

[Signature page of resolutions of the Board of NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI]

Name: Keping Zha

Title: Chairman of the Board

Name: Erol Kohen

Title: Vice Chairman of the Board

Name: Yongjian Xu

Title: Member

Name: Xueyun Le

Title: Member

Name: Mustafa Nezh Kubac

Title: Member

**2. Duke konsideruar që viti 2019 ka rezultuar me humbje financiare, shoqëria nuk mund të shpërndajë fitim/dividend.**

Përfaqësuesi ka të gjitha kompetencat në lidhje me procesin e vendimmarrjes së sipërcituar të shoqërisë "BERALB" SHA.

[nënshkrimet v/juese]

[faqja e nënshkrimeve të vendimeve të Bordit të "NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI"]

Emri: Keping Zha

Pozicioni: Kryetar i Bordit

Emri: Erol Kohen

Pozicioni: Zv. Kryetar i Bordit

Emri: Yongjian Xu



Pozicioni: Anëtar

Emri: Xueyun Le

Pozicioni: Anëtar

Emri: Mustafah Nezh Kubac

Pozicioni: Anëtar

<p>Name: <i>Esin İffet Atlı</i> Title: <i>Member</i></p>  <p>[Seal - Nesko Metal Sanayi ve Ticaret A.S.]</p>	<p>Emri: <i>Esin İffet Atlı</i> Pozisyonu: <i>Anëtar</i></p>  <p>[Vula - Nesko Metal Sanayi ve Ticaret A.S.]</p>
---	--

**NESKO METAL**  
SANAYİ VE TİCARET A.Ş.

*A. Atlı*

4

*8*

*AK*

*H*

*77*

Beralb sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2019  
(Në '000 ALL)

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Punime kapitale nëntokesore	6	1,008,110	1,100,221
Aktivët afatgjata materiale	6	950,472	1,096,819
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>1,958,582</b>	<b>2,197,040</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventarë	7	215,404	201,537
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	130,673	1,385
Aktive të tjera afatshkurtra	9	221,656	120,773
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	10	212,726	12,225
Mjetet monetare në arkë e në bankë	11	6,944	9,151
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>787,403</b>	<b>345,071</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,745,985</b>	<b>2,542,111</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar/themeltar		7,725,952	7,285,000
Kapitali i nënshkruar i papaguar		(16,209)	(107,065)
Rezerva ligjore		341,197	341,197
Humbje e akumuluar		(5,591,161)	(4,541,207)
Rezultati i ushtrimit		(178,163)	(1,049,954)
<b>Totali i kapitalit</b>	12	<b>2,281,616</b>	<b>1,927,971</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata	13	-	67,017
Detyrime për çështje gjyqësore	14	6,514	6,514
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	-	62,157
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>6,514</b>	<b>135,688</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra	13	67,536	165,878
Llogari të pagueshme tregtare	16	323,918	197,307
Detyrime ndaj punonjësve	17	57,366	78,460
Shpenzime të përlllogaritura	18	2,618	34,704
Detyrime tatimore	19	6,417	2,103
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>457,855</b>	<b>478,452</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>464,369</b>	<b>614,140</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>2,745,985</b>	<b>2,542,111</b>

Pasqyrat financiare individuale duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar nga Menaxhimi më \_\_\_/\_\_\_/2020 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Migjela Xhani  
Përgatitësi i Pasqyrave  
Financiare

Mustafa Nezih Kubac  
Përfaqësues Ligjor



Yongjian XU  
Përfaqësues Ligjor

*(Handwritten signature)*

Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019  
(Në '000 ALL)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi para tatimit		
Axhustime për zërat jo-monetare:	(178,163)	(1,049,954)
Amortizimi		
Zhvlerësimi	297,289	306,026
Shpenzime për interesa	57,120	789,753
Diferenca konvertimi të parealizuara	10,383	18,650
Ndryshimi në kapitalin qarkullues	11,014	(1,019)
Rënie/(rritje) në inventar		
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(13,867)	(153,048)
Rënie/(rritje) në aktive të tjera	(138,683)	5,193
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	(88,658)	(89,939)
Rritje/(rënie) në detyrimet për punonjësit	132,046	56,092
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	(21,094)	34,218
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(32,086)	-
	(212,726)	-
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>(177,425)</b>	<b>(84,028)</b>
Interesa të paguara	(10,383)	(18,650)
Kapitalizimi i balancave të palëve të lidhura	-	194,601
	<b>(10,383)</b>	<b>175,951</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata		
Të ardhura nga shitja AAM-ve	(115,951)	(31,822)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>-</b>	<b>2,911</b>
	<b>(115,951)</b>	<b>(28,911)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Pagesa të kryera për huatë me palët e lidhura	(62,157)	(125,047)
Pagesa të kryera për shlyerjen e huasë		
Pagesa të kryera për kapitalin aksionar	(168,849)	(174,092)
	531,808	231,492
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>300,802</b>	<b>(67,647)</b>
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		
Mjetet monetare në fillim të periudhës	(2,207)	(4,635)
Efekt i kursit të këmbimit në mjetet monetare dhe ekuivalentëve në monedhë të huaj	9,151	12,767
	750	1,019
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>6,944</b>	<b>9,151</b>

12

Pasqyrat financiare individuale duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiar

1.





Beralsk shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019  
(Në '000 ALL)

Pozicioni financiar më 1 janar 2018	Kapitali			Rezerva Ligjore	Humbe e Akumuluar	Humbeja e vitit	Totali
	aksionar	Kapitali i nënshkruar i papaguar	Kapitali i nënshkruar				
Kapitalizimi I balancave me palët e lidhura	194,601	-	-	341,197	(4,541,207)	-	2,551,832
Humbeja neto e vitit	231,492	-	-	-	-	-	194,601
Emetimi I aksioneve te zakonshme	107,065	(107,065)	-	-	-	-	231,492
Kapitali i nënshkruar i papaguar	-	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>7,285,000</b>	<b>(107,065)</b>	<b>341,197</b>	<b>341,197</b>	<b>(4,541,207)</b>	<b>(1,049,954)</b>	<b>(1,049,954)</b>
Humbeja neto e vitit	440,952	-	-	-	-	-	1,927,971
Kapitalizimi I balancave me palët e lidhura	-	-	-	-	-	-	440,952
Transferim në Humbeje të mbartura	-	90,856	-	-	-	-	90,856
Kapitali i nënshkruar i papaguar	-	-	-	-	(1,049,954)	1,049,954	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	<b>7,725,952</b>	<b>(16,209)</b>	<b>341,197</b>	<b>341,197</b>	<b>(5,591,161)</b>	<b>(178,163)</b>	<b>(178,163)</b>
<b>Pasqyrat financiare Individuale duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.</b>							<b>2,281,616</b>



Beralb sh.a.s

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumatat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019  
(Në '000 ALL)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	
Të ardhura të tjera	21	492,100
<b>Total të ardhura</b>	<b>1,328,440</b>	<b>19,987</b>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	22	512,087
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	23	(435,945)
Shpenzime personeli	24	202,611
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi		(89,597)
Shpenzime operative	25	(306,026)
Zhvlerësim i aktiveve		(152,837)
<b>Total shpenzime</b>	<b>(1,531,479)</b>	<b>(789,753)</b>
Fitim neto nga përkthimi i monedhave	26	(11,005)
Të ardhura/shpenzime për interesa (neto)	27	28,156
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>	<b>(178,163)</b>	<b>(18,650)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	28	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>	<b>(178,163)</b>	<b>(1,049,954)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>(178,163)</b>	<b>(1,049,954)</b>

Pasqyrat financiare individuale duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.



Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 2. Informacion i përgjithshëm

Beralb SHA është një shoqëri aksionare e themeluar dhe e vendosur në Republikën e Shqipërisë në bazë të vendimit të Gjykatës Tiranë Nr. 25300, datë 26 shkurt 2001, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT K12107002A. Pronari i vetëm i Shoqërisë është NESKO METAL SANAYI VE TICARET SİRKETİ, i regjistruar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe e vendosur në Turqi. Palët e lidhura dhe kontrolluese të Shoqërisë janë Ekin Maden Ticaret ve Sanayi. A.S e cila zotëron 50% të aksioneve të Shoqërisë mëmë, e ndjekur nga Jiangxi Copper Co. e cila zotëron 48%, Beijing Metal Challenge Global Trading Co 1% dhe CRM International Co. LTD 1%.

Shoqëria operon me një marrëveshje koncesioni 42 vjeçare të dhënë nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë) e Republikës së Shqipërisë, e cila fillimisht ka qenë një marrëveshje koncesioni për 30 vite. Sipas marrëveshjes së mëparshme të koncesionit, Shoqëria kishte të drejtën ekskluzive për të shfrytëzuar minierat e përmendura më poshtë deri më 2 prill 2031. Në qershor të vitit 2017, periudha u zgjat deri më 17 prill 2043. Marrëveshja përfshin minierën e bakrit Munella, minierën e bakrit Lakrosh dhe dy uzinat e pasurimit një në Fusharrëz dhe tjetra në Shkodër. Veprimtaria kryesore e Shoqërisë është të zhvillojë, ndërtojë dhe modernizojë industrinë e minierave në Shqipëri, të kryejë studime dhe eksplorime gjeologjike dhe minerale, për të kryer importimin dhe eksportimin e mineraleve.

Operacionet e shoqërive drejtohen nga Këshilli i Administrimiti cili përbëhet nga gjashtë anëtarë:

Z. Yongjian Xu  
Z. Kebing Zh.a  
Z. Esin Ifet Atli  
Z. Mustafa Nezir Kubac  
Z. Erol Kohen  
Z. Peng Liu

Këshilli i Administrimit ka emëruar një Bord Menaxhues të përbërë nga:

Z. Yongjian Xu, Administrator  
Z. Mustafa Nezir Kubac, Administrator

Gjatë vitit 2014, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dha një licencë për aktivitetet e shfrytëzimit dhe vlerësimit për katër miniera të tjera: Qafë Bari, Karma, Tuc dhe Palucë. Që nga shkurti i vitit 2014, drejtimi vendosi në ruajtje minierën e Lakrosh deri në një lëvizje të favorshme të çmimit në tregun e bakrit. Në shtator të vitit 2015, drejtimi vendosi në ruajtje minierën e Munellës deri në një lëvizje të favorshme të çmimit në tregun e bakrit. Aktualisht, eksplorimi dhe nxjerrja e mineraleve të bakrit ka filluar përsëri nën marrëveshjen e nënkontraktorit të muajit nëntor 2017.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është Rr. "Papa Gjon Palli II". ABA Business Centre, kati i 13-të, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2019 numri i punonjësve është 32 (2018: 30 punonjës).

## 3. Bazat e përgatitjes

### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe në përputhje me ligjin shqiptar Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

### 2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.



*[Handwritten signature]*  
7

## 2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

### 2.3 Vijimësia

Drejtimi i përgatit këto pasqyra financiare duke u bazuar në parimin e vijimësisë.

Referohuni Shënimit 5.1 për pasiguri në lidhje me ngjarjet dhe kushte që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në bazë të parimit të vijimësisë.

### 2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencat e mëparshme, si dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë këtu dhe vlerësimet për ngjarje të ardhshme, që besohet të jetë e arsyeshme të merren në konsideratë rrethanat aktuale të tyre.

Fushat që kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare lidhen me:

- (i) Jetën e dobishme të aktiveve afatgjata, të cilat paraqiten në shënimin shpjegues 5.3.
- (ii) Testin e zhvlerësimit të aktiveve afatgjata dhe supozimet kyçe lidhur me vlerat e rikuperueshme, të cilat paraqiten në Shënimin shpjegues 6 (i).

## 3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

### 3.1 Standardet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale

#### Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë"

Politikë e aplikueshme që nga 1 janari 2019.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operationale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi në fjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qira financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë.

Shoqëria ka analizuar qiratë dhe i ka përjashtuar ato nga klasifikimi si qira financiare sepse janë:

- Qira afatshkurtra për një periudhë më të vogël se 12 muaj.
- Qira me vlera të ulta.



Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë"

Politikë e aplikueshme që nga 1 Janari 2019.

Tabela në vijim paraqet një rakordim të angazhimeve të qirasë operative:

**Shuma të njohura në të ardhura dhe shpenzime**

Shpenzime amortizimi për të drejtat e përdorimit	-
Shpenzime interesi (përfshirë në kostot financuese)	-
Kosto qiraje lidhur me qiratë afatshkurtra	15,409
	<u>15,409</u>

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 Janar 2019, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures – Amendimet e SNK
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2015- 2017
- Plan i ndryshimit ose zgjidhjes – Amendimet në SNK 19
- Interpretimi 23 Pasiguria mbi trajtimin e tatimit të të ardhurave
- KIRFN 23 Pasiguria mbi pozicionet e tatimit mbi të ardhurat (efektive nga 1 Janar 2019)
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015 -2017) (detyrimisht efektive për periudhën që fillon më 1 Janar 2019)
- Amendimet në SNRF 9 Karakteristikat e parapagimit me kompensim negative (efektive nga 1 Janar 2019)
- Amendimet në SNK 19 "Planet e ndryshimit, mbylljes ose zgjedhjes"(detyrimisht efektive për periudhat nga ose pas 1 Janar 2019)
- Amendimet në SNK 28 "Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures" (detyrimisht efektive për periudhat më ose pas 1 Janar 2019)
- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" (detyrimisht efektive për periudhat më ose pas 1 Janar 2021)

3.2 Standardet dhe Interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Bordi Nderkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standard dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standard dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2019:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve – efektive për periudhat pas 1 Janar 2021
- Amendimet e SNK 1 dhe SNK 8 – efektive për periudhat pas 1 Janar 2020
- Amendimet e SNRF 3 – efektive për periudhat pas 1 Janar 2020
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar – efektive për periudhat pas 1 Janar 2020



Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

#### 4. Politika të rëndësishme kontabël

##### 4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/ Lek	121.77	123.42
USD/Lek	108.64	107.82

##### 4.2 Instrumenta financiarë

Një Instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.


**Instrumentat financiare – njohja fillestare.** Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kreditë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes.** Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja fluksin e mjeteve monetare kontraktuale dhe fluksin e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar fluksin e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

**Aktivitet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare.** Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse fluksin e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse fluksin e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kreditë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktiviteti financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH.



*[Handwritten signature]*

Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek. përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

#### 4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### 4.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

**Aktivet financiare** – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

**Aktivet financiare - çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

**Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.


**Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

**Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

##### Vlera e drejtë

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshkohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.



*[Signature]* 11

Beralb sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilesohet ndryshe)

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principallit, plus interesin e përlogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiar.

#### 4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### 4.3 Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit, kostoja e mineralit dhe koncentratit të bakrit përfshin materialet e papërpunuara, punën e drejtpërdrejtë, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet e tjera të drejtpërdrejta (duke përfshirë shërbimet e jashtme dhe amortizimin) dhe shpenzimet direkte të prodhimit, por përjashton kostot administrative dhe financiare.

Kostoja e inventarëve përcaktohet me metodën e koston FIFO.

Inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

Vlera neto e realizueshme është me çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë aktivitetit normal minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

##### 4.4 Punime kapitale nëntokësore

Punimet kapitale nëntokësore rezultojnë në shpenzime kapitale lidhur me sigurimin e aksesit afatgjatë në trupin e xeherorit dhe punëve të tjera përgatitore për aktivitetet minerare siç janë konstruksionet, tubacioni, furnizimi me energji dhe ventilimi.

Të gjitha shpenzimet që lidhen me riparimet kryesore, aksesit në vendburimin e xeherorit dhe ventilimit grupohen në punime kapitale nëntokësore.

Kriteret e mëposhtme janë aplikuar për diferencimin e punimeve kapitale nëntokësore nga shpenzimet e zhvillimit të prodhimit:

- Të gjitha shpenzimet e bëra pas aksesit në vendburimin e xeherorit konsiderohen si kosto zhvillimore operative
- (zhvillimi i prodhimit të xeherorëve) dhe përfshihen në koston e xeherorëve të ngritur.

Shpenzimet për zhvillimin e kapitalit nëntokësor kapitalizohen në mënyrë proporcionale bazuar në raportin inxhinierik, i cili konfirmon situatën e progresit të punës të kapitaleve nëntokësore.

Kostot e zhvillimit të kapitalit zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit me vlerën e pritshme të dobishme deri në 42 vjet.

Sipas marrëveshjes së mëparshme të koncesionit, Shoqëria ka pasur të drejtat ekskluzive për shfrytëzimin e minierave të lartpërmendura deri më 2 prill 2031. Në qershor 2017, periudha u zgjat deri më 17 prill 2043 (shih shënimin shpjegues 1).

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Miniera Munella	Deri në 24 vite	Deri në 25 vite
Miniera Lak Rosh	Deri në 23 vite	Deri në 24 vite

Në çdo datë raportimi, jeta e pritshme e zhvillimit të kostove nëntokësore të zhvillimit të kapitalit rishikohet për zhvlerësim. Gjithashtu rishikohen dhe rezervat e provuara dhe të mundshme, ndërsa prodhimi përlogaritet në bazë të vlerësimit të rezervave më të fundit, bërë nga hulumtimet gjeologjike të kryera nga njësia ekonomike (shiko shënimin 5.3).

##### 4.5 Aktive Afatgjata Materiale

###### (i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja historike përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivit.



*[Handwritten signature]*



Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

*(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)*

Kostoja përfshin koston e ndërtimit ose çmimin e blerjes, përfshirë detyrimet e importit dhe taksat e parimbursueshme dhe çdo kosto drejtpërdrejtë të lidhur me sjelljen e aktivit në gjendje pune për përdorimin e tij të synuar, shpenzimet e instalimit, tarifat profesionale si për arkitektët dhe inxhinierët dhe koston e vlerësuar për çmontimin dhe heqjen e aktivit dhe kthimin e vendit në gjendjen e mëparshme, në masën që ajo njihet si një provizion sipas SNK 37 "Provizionet, Pasivet dhe Aktivet e Kushtëzuara



*Handwritten signature in blue ink.*

Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.5 Aktive Afatgjata Materiale (vazhdim)

(i) Njohja dhe matja (vazhdim)

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet në bazë lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktiveve. Amortizimi i ndërtimeve në proces fillon kur aktivi është në dispozicion për përdorim. Toka nuk zhvlerësohet. Normat vjetore të amortizimit për klasat kryesore të aktiveve afatgjata materiale janë si më poshtë:

Kategoria aktivitet	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Ndërtesa Munella dhe Lak Rosh	20 years	20 years
Makineri dhe pajisje – Munella dhe Lak Rosh	10 years	10 years
Makineri dhe pajisje – Fabrika Fush Arrëz	20 years	20 years
Mjete transporti	10 years	10 years
Pajisje zyre	10 years	5 years
Pajisje kompjuterike	5 years	4 years

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi nga drejtimi i Shoqërisë. Vlera kontabël neto do të ulet deri në vlerën e rikuperueshme nëse ajo tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit.

(iv) Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.


Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.6 Mjetet monetare dhe ekuivalentët

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj paraqiten me vlerën e drejtë. Për qëllimet e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë të cilat kanë maturitet tre muaj ose më pak.

4.7 Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Dividentët në aksionet e zakonshme njihen si një zbritje nga kapitali në periudhën në të cilën ato deklarohen. Kostot e jashtme shtesë që lidhen drejtpërdrejt me emetimin e aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje nga të ardhurat, neto nga tatimet.



*[Handwritten signature]*

#### 4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### 4.7 Kapitali aksionar (vazhdim)

Në rastet kur Shoqëria blen aksionet e veta, shuma e paguar, përfshirë çdo kosto të jashtme shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejtë, neto nga taksat mbi të ardhurat, zbritet nga totali i kapitalit të aksionarëve si aksione të thesarit derisa ato të anulohen. Kur aksionet e tilla më pas shiten ose rëmëtohen, çdo shumë e marrë përfshihet në kapitalin aksionar. Kapitali i nënshkruar i papaguar përbëhet nga aksionet e emetuara nga Shoqëria, por që nuk janë injektuar ende si mjete monetare për veprimtarinë e shoqërisë nga aksionarët.

##### 4.8 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë të marrë, neto nga kostot fillestare të drejtpërdrejta për lidhjen e kontratës. Pas njohjes fillestare, huatë që mbartin interes regjistrohen me kosto të amortizuar, me metoden e normes së interesit efektiv. Cdo diferencë midis shumave të marra (neto nga kostot fillesate të drejtpërdrejta) dhe vlerës së rimarrjes njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes. Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveçse kur Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas dates së raportimit.

##### 4.9 Logaritë e pagueshme

Të pagueshmet tregtare i referohen të pagueshmeve për shërbimet ose mallrat nga furnitorët gjatë aktiviteteve të rregullta tregtare. Ato klasifikohen si detyrime afatshkurtra nëse pagesa është brenda një viti ose më pak (ose brenda ciklit të rregullt të aktiviteteve operative nëse është më e gjatë); përndryshe, ato njihen si detyrime afatgjata.

Të pagueshmet tregtare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### 4.10 Të ardhurat


E ardhura nga shitja e mallrave lidhet me shitjen e mallrave me një çmim të caktuar. Detyrimi është që të shpërndahet një seri mallrash të dallueshme dhe çmimi i transaksionit është shuma që Shoqëria pret të marrë, qoftë me çmimin e shitjes në atë moment ose me çmimin e kontratës. Detyrimi realizohet në kohë, kështu që e ardhura njihet për çdo njësi të shitur me çmimin e transaksionit.

Shoqëria njih të ardhurat kur plotëson (ose në masën që plotëson) kushtin e performancës duke transferuar mallin e premtuar (bakër) tek një klient. Një aktiv konsiderohet i transferuar nëse (ose në masën që) klienti kontrollon atë aktiv.

##### 4.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Shoqëria nuk ka njohur ndonjë provizion për rehabilitimin e mjedisit duke qënë se sipas marrëveshjes së koncesionit përcaktohet se shoqëria nuk ka detyrim apo kosto të pritshme për rehabilitimin e terreneve të dëmtuara, si dhe kosto të pritshme nga nxjerrja jashtë përdorimit e pajisjeve fikse pas përfundimit të aktiviteteve minerare. Shoqëria duhet t'i dorëzojë të gjitha objektet në kushte të shfrytëzueshme. Bazuar në kërkesat lokale, Shoqëria ka vendosur një garanci për të siguruar që objektet t'i dorëzohen Ministrisë në fund të kushteve të koncesionit. Bazuar në kërkesat lokale, Shoqëria paguan çdo vit një depozitë garancie e cila njihet si shpenzim pasi këto shuma nuk janë të rikuperueshme dhe do të përdoren nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës në fund të kushteve të koncesioneve, për rehabilitimin të mjedisit.



15  
A. Cef

Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

#### 4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### 4.12 Përfitimet e punëmarrësve

###### Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

##### 4.13 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Normat e tatimit për vitin 2019 është 15%. (2018: 15%)

Tatimet e shtyra janë llogaritur duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen efektive në fund të periudhës raportuese, të cilat priten të aplikohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitetet tatimore të shtyra njihen në atë masë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm, kundrejt të cilit ato të mund të përdoren.

Shoqëria i ka vlerësuar efektet e tatimit të shtyrë, por nuk i ka njohur në Pasqyrat Financiare, për shkak të humbjes së akumuluar gjatë viteve të fundit.

##### 4.14 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

##### 4.15 Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



*[Handwritten signature]*  
17

Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 5. Gjyklime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

### 5.1 Vijimesia

Gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2019, Shoqëria pësoi një humbje neto para tatimit prej 178,163 mijë lekësh (më 31 Dhjetor 2018: 1,049,954 mijë Lekë) dhe grumbulloi humbje për një shumë prej 5,591,161 mijë Lekë (2018: 4,541,207 mijë Lekë).

Çmimet e mallrave janë një nga përcaktuesit kryesorë të rezultateve të operacioneve dhe gjendjes financiare të Shoqërisë, pasi çmimet e mallrave janë më të ulëta në krahasim me koston e prodhimit të Shoqërisë. Drejtimi përcakton që Shoqëria mund të operojë nëse çmimet në treg rriten me një çmim të qëndrueshëm mbi 6,500 USD për ton, në mënyrë që të jenë në gjendje të gjenerojnë fitime. Bazuar në koston e vlerësuar nga drejtimi, kostoja e prodhimit të Shoqërisë arrin në 6,500 USD për ton në gjendjen aktuale të fabrikës dhe minierave të Shoqërisë.

Nisur nga faktori i mësipërm, Shoqëria ndërpreu aktivitetin e saj të nxjerrjes dhe prodhimit në 2015 pasi çmimet e bakrit ishin më të ulëta në krahasim me koston e prodhimit të Kompanisë dhe u rifillua përsëri gjatë vitit 2018, kur çmimet ishin rikuperuar në shumën prej 6,500-7,000 USD. Bazuar në këtë situatë, drejtimi ka vendosur të gjitha minierat në ruajtje deri në lëvizje të favorshme të çmimeve në tregun e bakrit. Çmimet e bakrit ndikohen nga faktorë të shumtë jashtë kontrollit të Shoqërisë, duke përfshirë shitjen ose blerjen e bakrit nga shoqëri të ndryshme, normat e këmbimit valuator, inflacioni ose deflacioni, furnizimi dhe oferta globale dhe rajonale, dhe kushtet politike dhe ekonomike të vendeve të prodhimit të bakrit anembanë botës. Drejtimi i Shoqërisë pret paqëndrueshmëri në një afat të shkurtër, bazat afatgjata për industrinë e bakrit mbeten pozitive. Urbanizimi i vazhdueshëm, industrializimi dhe elektrifikimi i Kinës dhe tregjeve të tjera të mëdha si India dhe Azia Juglindore, e kombinuar me kërkesa më të mëdha për efikasitet energjetik dhe lëvizja drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë, do të rrisin kërkesën afatgjatë të bakrit. Drejtimi i Shoqërisë beson se Shoqëria është e pozicionuar mirë për të përfituar nga këto dinamika të fuqishme të tregut ndërkombëtar. Duke patur parasysh ngjarjet dhe kushtet e mësipërme, një pasiguri materiale që mund të sjellë në dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar mbi bazen e parimit të vijimesisë, ekziston në datën e raportimit. Megjithatë, drejtimi i Shoqërisë e konsideron të përshtatshme që pasqyrat financiare të përgatiten në bazë të parimit të vijimesisë, i cili supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë aktivitetet e saj dhe të shlyejë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit.

Për më tepër, nevojat financiare të Shoqërisë do të mbështeten nëpërmjet huazimeve nga bankat (për detaje ju lutem referojuni shënimit 13) dhe nga financimi i aksionarëve (për detaje ju lutemi referojuni shënimit 12). Gjatë vitit 2018, Shoqëria ka rifilluar procesin e ekstraktimit nëpërmjet nënkontraktuesit RT Minerale SHPK bazuar në marrëveshjen nr.1536 të datës 01 nëntor 2017 dhe aktivitetin e shitjes gjatë muajit qershor 2018 me shoqërinë mëmë. Gjatë vitit 2019 qarkullimi i Shoqërisë nga aktiviteti i shitjes së bakrit, arriti në rreth 1,285 591 mijë lekë.

Pas vendimit të Bordit të Drejtorëve më 9 mars 2018, rritja shtesë e kapitalit aksionar nga aksionarët është lëshuar në shumën totale prej 440,952 mijë lekë (vlera ekuivalente në lekë i shumës 4,000 mijë USD). Shoqëria nuk ka qëllim të likuidojë ose të ndërpresë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2019. Drejtimi pret që Shoqëria të jetë fitimprurëse në të ardhmen dhe aftësia e saj për të vazhduar sipas parimit të vijimesisë nuk do të zhvlerësohet.



*[Handwritten signature]*  
10

Beralb sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

### 5.2 Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijmësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj.) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijmësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

### 5.3 Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata

Në çdo datë raportimi, drejtimi vlerëson jetëgjatësinë e dobishme të aktiveve afatgjatë dhe koston e amortizimit. Ky vlerësim bazohet në përvojën e drejtimit, praktikën e industrisë dhe karakteristikat e aktivitetit. Vlerësimet e drejtimit për jetën e dobishme të aktiveve mund të ndryshojnë ndjeshëm si rezultat i ndryshimeve në mjedisin e biznesit. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjatë lidhet drejtpërdrejt me jetën e dobishme të minierave, e cila përcaktohet nga nivelet e rezervave të bakrit brenda minierave. Për kryerjen e një vlerësimi të saktë të jetës së dobishme të minierave, drejtimi kryen studimet vjetore të matjeve gjeologjike në bashkëpunim me inxhinierët. Si rezultat i rritjes së periudhës së koncesionit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nivelet e rezervave të siguruara nga matjet gjeologjike gjatë vitit 2019 kanë shtyrë drejtimin të rivlerësojë jetën e dobishme të minierave të Shoqërisë. Jeta e dobishme e vlerësuar më 31 dhjetor 2019 për minierën e Munellës është 24 vjet me një jetë të dobishme të mbetur deri në 24 vjet dhe për minierën Lak Rosh është 23 vjet.

Aktivitetet e punimeve nëntokësore të minierave amortizohen gjatë një jete të dobishme në bazë të metodës lineare. Drejtimi konsideron që baza e metodës lineare përfaqëson metodën e njësishme të prodhimit, sepse aktivitetet e Shoqërisë shfrytëzohen pothuajse plotësisht në tërë jetën ekonomike.

Kërkimi i burimeve minerale është një proces i ndërlikuar i cili kërkon interpretime dhe vlerësime të besueshme në lidhje me të dhënat ekonomike dhe gjeologjike. Çdo ndryshim në këto interpretime mund të çojë në ndryshime në jetën e dobishme ose në zhvlerësimin e kostove të kapitalizuara të punimeve kapitale nëntokësore ose kostove të shtyra të eksplorimit. Drejtimi ka kryer studime të matjeve gjeologjike për përcaktimin e niveleve të rezervave në minierat Munella dhe Lak Rosh në vitin 2019 dhe i përditëson çdo vit.

Rezervat e përgjithshme të identifikuara më 31 dhjetor 2019 në minierën e Munellës vlerësohen nga ekspertët e Shoqërisë në 6,194,000 ton të 1,31% të cilësisë së bakrit dhe konsiderohen të arritshme.

Rezervat e përgjithshme të identifikuara më 31 dhjetor 2019 në minierën e Lakrosh vlerësohen në 1,979,000 ton të 1.452% të cilësisë së bakrit dhe konsiderohen të arritshme. Rezervat në miniera të tjera më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

Miniera	Rezerva në Ton	% Cu
Munella	6,194,000	1.31
Lak Rosh	1,979,000	1.452
Karma	963,000	2.50
East Tuc	680,000	2.110
Qafë Bari	338,000	1.810
Palucë	323,000	1.350
Fushë Arrëz	809,000	1.34

Rezervat përcaktohen në përputhje me metodologjinë e përdorur nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në Shqipëri.



Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Toka dhe ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Punime kapitale nëntokësore	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	1,054,043	2,202,735	379,039	2,159	27,064	2,511,519	6,176,559
Shtesa	11,364	15,766	429	429		4,262	31,821
Pakësime	-	(129,419)	(6,581)	(1,547)	(22,011)	-	(159,558)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,065,407</b>	<b>2,089,082</b>	<b>372,458</b>	<b>1,041</b>	<b>5,053</b>	<b>2,515,781</b>	<b>6,048,822</b>
Shtesa	38,684	68,815	475	475		7,977	115,951
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,104,091</b>	<b>2,157,897</b>	<b>372,458</b>	<b>1,516</b>	<b>5,053</b>	<b>2,523,758</b>	<b>6,164,773</b>
<b>Amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar</b>							
Gjendja më 1 janar 2018	491,639	1,195,198	255,525	1,370	22,411	946,507	2,912,650
Amortizimi i vitit	52,630	140,483	36,515	689	2,470	73,239	306,026
Pakësime	-	(129,419)	(3,670)	(1,547)	(22,011)	-	(156,647)
Humbje nga zhvlerësimi	137,807	233,448	22,895	-	-	395,603	789,753
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>682,076</b>	<b>1,439,710</b>	<b>311,265</b>	<b>512</b>	<b>2,870</b>	<b>1,415,349</b>	<b>3,851,782</b>
Amortizimi i vitit	53,339	135,717	36,865	255	517	70,596	297,289
Humbje nga zhvlerësimi	10,460	16,267	690	-	-	29,703	57,120
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>745,875</b>	<b>1,591,694</b>	<b>348,820</b>	<b>767</b>	<b>3,387</b>	<b>1,515,648</b>	<b>4,206,191</b>
<b>Vlera-neto kontabël</b>							
Gjendja më 31 dhjetor 2018	383,331	649,372	61,193	529	2,183	1,100,432	2,197,040
Gjendja më 31 dhjetor 2019	358,216	566,203	23,638	749	1,666	1,008,110	1,958,582

Vlera-neto kontabël

Gjendja më 31 dhjetor 2018

Gjendja më 31 dhjetor 2019



Beralb sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(I) Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

Siç përshkruhet në shënimin 1, Shoqëria ndaloi aktivitetin e nxjerrjes së mineraleve që nga viti 2015, për shkak të kushteve të pafavorshme të tregut në lidhje me çmimin ndërkombëtar të produkteve të saj dhe si rezultat përfundoi kontratat e punës me personelin e minierës. Për më tepër, me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria pësoi një humbje neto para taksave për një shumë prej 178,163 mijë lekësh (më 31 Dhjetor 2018: 1,049,954 mijë Lek) dhe ka grumbulluar humbje për një shumë prej 5,591,161 mijë Lekë (2018: 4,541,207 Lek mijë).

Për këtë qëllim, më 31 dhjetor 2019, Shoqëria kreu një provë zhvlerësimi për zhvillimin e tij të kapitalit nëntokësor dhe pronës dhe pajisjeve, dhe vlerësoi shumën e rikuperueshme të tyre në 31 dhjetor 2019.

Për qëllime të testimit të zhvlerësimi, Drejtimi alokoi të gjitha pasuritë e testuara në tre njësi gjeneruese të parasë ("NGJP"), përkatësisht Munella, Karma dhe Miniera Lakrosh. Më 31 Dhjetor 2019, vlera kontabël e kostos së zhvillimit nëntokësor dhe aktiveve afatgjata materiale, të përfshira në NGJP arritën përkatësisht 980,963 mijë Lek dhe 977,889 mijë Lek (2018: 1,100,221 Lek dhe 1,096,819 mijë Lek).

Shuma e rikuperueshme u bazua në vlerën në përdorim, të përcaktuar sipas gjykimit të rëndësishëm dhe supozimeve të përdorura, duke zbritur flukset e ardhshme të parave që do të gjenerohen nga përdorimi i vazhdueshëm i NGJP-së. Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e vlerës në përdorim janë dhënë më poshtë:

Çmimi	2019
Norma e zbritjes	6,618
Indeksi i rritjes së çmimit	12%
Indeksi i rritjes së kostos së prodhimit	2.5%
	1.75%

Norma e skontimit përdor një masë para tatimit bazuar në koston mesatare të ponderuar të kapitalit.

Teknikat e rrjedhës së mjeteve monetare bazohen në buxhetet dhe planeve të biznesit më të fundit të aprovuara, të cilat mbështeten dhe nga jeta e minierave e planifikuar për operacionet përkatëse. Modelet e vlerësimit përdorin vlerësimet më të fundit të rezervës dhe të burimeve, supozimet përkatëse të kostos në përgjithësi bazuar në përvojën e kaluar, parashikimet e tregut të çmimeve të mallrave dhe supozimet e kursit të këmbimit.

Testi i zhvlerësimi aplikon metodën Graduale për vlerësimin e çmimeve. Parashikimi i çmimit të bakrit rritet çdo vit me një normë specifike rritjeje. Shkalla e rritjes bazohet në CAGR historike të çmimit të bakrit (duke marrë parasysh edhe luhatjet historike të çmimeve dhe / ose ciklet).

Periudha e planifikimit përfshin periudhën e pritshme të koncesionit të ekstrapolimit dhe të minierave (shih shënimin 5.3).

Vlerat e caktuara për supozimet kryesore paraqesin vlerësimin e drejtimit të tendencave të ardhshme në industri dhe janë bazuar në të dhënat historike nga burimet e jashtme dhe të brendshme dhe parashikimet e rrjedhës së flukseve të parase përfshijnë vlerësime për periudhën e koncesionit.

Vlerat në përdorim janë veçanërisht të ndjeshme ndaj ndryshimeve në çmimet e ardhshme të energjisë dhe kostos së ponderuar të kapitalit.





Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shummat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

#### 7. Inventarë

Në këtë zë janë përfshirë minerale dhe concentrate bakri, si dhe zhvlerësimi i inventarit, balanca e të cilëve më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mineral dhe Koncentrat bakri në vend	163,585	191,851
Lëndë e papërpunuara (Materiale)	419,669	423,799
Zhvlerësimi Inventarit	(367,850)	(414,113)
	<u>215,404</u>	<u>201,537</u>

<u>Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarëve</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Gjendja më 1 janar	414,113	458,047
Rimarrje për vitin	(46,263)	(43,934)
Gjendja më 31 dhjetor	<u>367,850</u>	<u>414,113</u>

Si rezultat i ndërprerjes së veprimtarisë së nxjerrjes dhe asaj operative që nga viti 2015 (shih shënimin 5.1), Shoqëria ka lëvizje të ngadalshme të inventarëve më të vjetër se 3 vjet në shumën prej 414,113 mijë Lek. Më 31 Dhjetor 2019, Drejtimi ka rimarrë pjesën e provizionit për produktet e përdorura duke marrë vlerën kontabël të inventarit në vlerën neto të realizueshme me 367,850 mijë lekë (2018: 414,113 mijë lekë).

#### 8. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare të shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	129,336	-
Klientë	1,337	1,385
	<u>1,337</u>	<u>1,385</u>

#### 9. Aktive të tjera afatshkurtra

Balanca e aktiveve të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH e arkëtueshme	221,251	119,651
Taksa Doganore të arkëtueshme	405	1,122
	<u>221,656</u>	<u>120,773</u>

Gjatë 2020 Shoqëria ka bërë një kërkesë ndaj autoriteteve tatimore për rimbursimin e vlerës së TVSH-së së arkëtueshme, të cilët ua kanë rimbursuar.



  
22

Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

#### 10. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Balanca e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime	61,718	12,225
Shpenzime të shtyra për punimet	119,254	-
Shpenzime të shtyra për siguracionin e fabrikave	30,533	-
Shpenzime të shtyra për energji	1,221	-
	<u>212,726</u>	<u>12,225</u>

#### 11. Mjetet monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare ne banke	6,927	9,066
Në Lekë	1,009	4,741
Në monedhë	5,918	4,325
Mjete monetare ne arke	17	85
Në Lekë	6	73
Në monedhë	11	12
	<u>6,944</u>	<u>9,151</u>

#### 12. Kapitali

Më 31 dhjetor 2019, kapitali i regjistruar dhe pjesërisht i paguar i Shoqërisë arrin në 7,725,952 mijë lekë dhe përbëhet nga 10,390 aksione të regjistruara me vlerë nominale 743,595 lek (31 dhjetor 2018: 7,285,000 mijë lekë, të përbërë nga 9,797 aksione me vlerë nominale 743,595 për aksion).

Bazuar në vendimin e datës 28 shkurt 2019, aksionarët kanë vendosur të rrisin kapitalin aksionar me 531,808 mijë lekë

Të gjitha aksionet janë në pronësi të aksionarit të vetëm të Shoqërisë, NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI. Palët perfundimtare kontrolluese të Shoqërisë janë Ekin Maden Ticaret ve San. A.Ş. dhe Jlangxi Copper Co., të cilat zotërojnë shoqërine mëmë direkte të Shoqërisë.

	Më 31 dhjetor 2019		Më 31 dhjetor 2018	
	Nr. i aksioneve	Ekivalent në mijë Lekë	Nr. i aksioneve	Ekivalent në mijë Lekë
NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI	10,390	7,725,952	9,797	7,285,000



23

Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 12. Kapitall (vazhdim)

Tabela më poshtë paraqet rakordimin e numrit të aksioneve në fillim dhe në fund të periudhës:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Numri i aksioneve të autorizuar dhe plotësisht të paguara në fillim të periudhës	9,797	9,080
Numri i aksioneve të emetuara gjatë periudhës	593	717
Numri i aksioneve të autorizuar dhe plotësisht të paguara në fund të periudhës	10,390	9,797

### Kapitall i regjistruar por i papaguar

Në 31 dhjetor 2019, , kapitall i regjistruar por i papaguar ishte në shumën 16,209 mijë lekë (31 dhjetor 2018:107,065 mijë lekë).

### Rezerva ligjore

Rezerva ligjore prej 5% mbi fitimin pas tatimit dhe para dividendit, krijohet në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare" deri në 10% të kapitalit aksionar. Rezerva ligjore nuk mbahet nëse Shoqëria ka humbje ose nëse arrin 10% të kapitalit aksionar.

## 13. Hua afatgjata

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pjesa afatgjate e huasë bankare	-	67,017
Pjesa afatshkurter e huasë bankare	67,536	165,878
	<u>67,536</u>	<u>232,895</u>

Më 22 shkurt 2013, Banka Societe Generale (tashmë OTP Bank) dhe Shoqëria nënshkruan një marrëveshje për një kredi afatmesme deri në 8,000 mijë dollarë amerikanë, ose ekuivalente me 848,000 mijë lekë, me kohëzgjatje katër vjet nga data e ndryshimit. Objekt i kolateralit janë të arkëtueshmet dhe inventarët nën pronësinë e Shoqërisë, makineritë ekzistuese dhe ato në të ardhmen me një vlerë kontabël jo më pak se 180% të kredisë dhe Garancia Korporative nga Ekin Maden Ticaret ve San. A.S. Shoqëria ka ripërtërirë kredinë me Societe Generale më 24 qershor 2016, me ristrukturimin e skemës së ripagimit dhe me një datë maturimi të re deri më 13 janar 2020.

Më 8 korrik 2015, Raiffeisen Bank Albania dhe Shoqëria nënshkruan një marrëveshje për linjën e kreditit për 5,900 mijë Euro ose ekuivalent 746,527 mijë lekë për 5 vjet nga data e marrëveshjes.

Kolateral i huasë janë:

- Peng mbi llogaritë rrjedhëse të Beralb SHA me Raiffeisen Bank
- Peng mbi të gjitha arkëtimet aktuale dhe të ardhshme të Beralb SHA
- Peng mbi asetet fikse të ardhshme dhe makineritë e Beralb SHA të financuara përmes huasë së Raiffeisen Bank sha
- Peng i aksioneve të Beralb SHA
- Peng për marrëveshjet e koncesionit për minierën Munella
- Peng mbi licencat e minierave për Paluca dhe Qaf Bari



Beralbit sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

*(Të gjitha shummat janë parazitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)*

- Garancia Korporative nga aksionerët kryesorë të Beralbit ("Ekin Maden Ticaret Ve Sanay AS" dhe "Jiangxi Copper Company LTD)



A handwritten signature in blue ink, consisting of a circle and several strokes.

Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shummat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

### 13. Hua afatgjata (vazhdim)

Kushtet e marrëveshjeve të huasë paraqiten si më poshtë:

	Data e fillimit	Data e maturimit	Interesi	Ekivalente në mijë lekë në 31 dhjetor 2019	Ekivalente në mijë lekë në 31 dhjetor 2018
OTP Bank (Societe Generale Albania)	22 shkurt 2013	13 janar 2020	Libor USD 12M +4.25%	5,219	65,025
Raiffeisen Bank Albania	8 korrik 2015	31 korrik 2020	Libor USD 12M +3.5%	62,317	167,870
				<u>67,536</u>	<u>232,895</u>

### 14. Detyrime për çështje gjyqësore

Balanca e provizioneve për çështje më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Provizion për çështje gjyqësore	6,514	6,514
	<u>6,514</u>	<u>6,514</u>

### 15. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Gjendja e llogarive të pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura	-	62,157
	<u>-</u>	<u>62,157</u>

### 16. Llogari të pagueshme tregtare

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të pagueshme afatshkurtra ndaj palëve të lidhura	24,382	-
Furnitorë për mallra dhe shërbime	299,536	197,307
	<u>323,918</u>	<u>197,307</u>

### 17. Detyrime ndaj punonjësve

Detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 vijojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime ndaj punonjësve	57,366	78,460
	<u>57,366</u>	<u>78,460</u>



*Handwritten signature*

Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

#### 18. Shpenzime të përllogaritura

Shpenzimet e përllogaritura të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime te llogaritura	2,618	34,704
	<u>2,618</u>	<u>34,704</u>

#### 19. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 vijojnë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për sigurime shoqërore	1,544	927
Detyrime për tatimin në burim	2,117	-
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat	2,756	1,176
	<u>6,417</u>	<u>2,103</u>

#### 20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit


Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e koncentratit te bakrit	1,285,591	492,100
	<u>1,285,591</u>	<u>492,100</u>

#### 21. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e materialeve	36,634	19,744
Të ardhura nga shitja AAM	-	(573)
Të ardhura të tjera	6,215	816
	<u>36,634</u>	<u>19,987</u>



Beralb shua

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Lëndë e parë dhe të konsumueshme	190,346	80,210
Rimarrje provizioni	(46,264)	-
Puna e nënkontraktorëve për mallrat e gatshme	652,598	355,735
	<u>796,680</u>	<u>435,945</u>

## 23. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi i gjendjes së produktit të gatshëm dhe prodhimit në proces për vitin 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Ndryshim gjendje produkt i gatshëm	28,266	(202,611)
	<u>28,266</u>	<u>(202,611)</u>

## 24. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime paga	95,119	78,996
Shpenzime për sigurime shoqërore	12,932	10,553
Shpenzime të tjera për personelin	-	48
	<u>108,051</u>	<u>89,597</u>

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 shoqëria ka një numër mesatar prej 32 punonjësish. Struktura paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Staf administrative	11
Inxhinierë	10
Staf operacional	11
	<u>32</u>



Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 25. Shpenzime operative

Shpenzimet operative të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Roje private	37,651	35,851
Shpenzime transporti	32,596	13,950
Sigurime	29,165	29,170
Shpenzime qiraje	15,409	15,561
Taksa të tjera	15,717	6,920
Shpenzime administrative nga palë të lidhura	20,437	9,940
Shpenzime ligjore e konsulenca	11,610	15,564
Mirëmbajtje dhe riparime	7,783	2,870
Provizion i aktiveve të tjera	-	5,012
Shërbime të ndryshme pika portuale	4,908	1,184
Shpenzime pune kërkimore	4,471	1,335
Udhëtime e dieta	1,833	2,318
Shpenzime telefon dhe internet	1,634	1,642
Komisione dhe tarifa bankare	1,685	1,176
Gjoha e dëmshpërblime	1,047	1,137
Shpenzime pritje përcjellje	490	228
Blerje energji, avull, ujë	442	1,316
Të tjera shpenzime	10,931	7,663
	<u>197,809</u>	<u>152,837</u>

Shpenzime ligjore e konsulenca përfshijnë shërbimet e auditimit të dhëna nga audituesi i pasqyrave financiare në shumën prej 2,618 mijë lekë.

## 26. Fitim neto nga përkthimi i monedhave

Fitim neto nga përkthimi i monedhave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Fitime nga përkthimi monedhave	6,335	33,603
Humbje nga përkthimi monedhave	(17,340)	(5,447)
	<u>(11,005)</u>	<u>28,156</u>





Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

**27. Të ardhura/shpenzime për interesa (neto)**

Shpenzimet e interesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime per interesa	(10,391)	(18,675)
Të ardhura nga interesat	8	25
	<u>(10,383)</u>	<u>(18,650)</u>

**28. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	(178,163)	(1,049,954)
Total shpenzime të panjohura	71,977	10,425
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(106,186)	(1,039,529)
Tatim fitimi @15%	-	-
	<u>(178,163)</u>	<u>(1,049,954)</u>

**29. Detyrime të kushtëzuara dhe angazhime**

Në rrjedhën e zakonshme të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në kërkesa dhe veprime juridike të ndryshme. Sipas vleresimit të drejtimit, disponimi përfundimtar i këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt të dëmshëm material mbi pozicionin financiar të Shoqërisë ose në ndryshimet në aktivet neto, përveç atyre për të cilat një provigjon është tashmë përfshirë në këto pasqyra financiare.

Angazhimet e qirasë operative. Kur Shoqëria është qiramarrëse, pagesat minimale të qirasë në të ardhmen do të rinovohen çdo vit. Pagesat minimale të pakthyeshme janë paraqitur më poshtë.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Jo më vonë se 1 vit	-	2,432
Totali i angazhimeve të qirasë operative	-	<u>2,432</u>



Beralb sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe.)

### 30. Transakionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura me efekt në pasqyrën e pozicionit paraqiten si më poshtë:

	Marrëdhënia	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
		Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Sirketi	Kompania mëmë	-	14,294	-	8,509
Ekin Maden Ticaret ve San. A.S.	Palë finale kontrolluese	129,219	10,088	-	53,629
Jiangxi Copper Co.	Palë finale kontrolluese	-	-	-	19
Vllahen Mining	Filial i shoqërisë mëmë	117	-	-	-
		<b>129,336</b>	<b>24,382</b>	<b>-</b>	<b>62,157</b>

Transaksionet me palët e lidhura me efekt në pasqyrën e performancës paraqiten si më poshtë:

	Marrëdhënia	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	
		Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Nesko metal sanayi ve ticaret sirketi	Kompania mëmë	-	24,716	-	12,619
Ekin Maden Ticaret ve San. A.S.	Palë finale kontrolluese	1,285,591	-	492,100	-
Vllahen Mining	Filial i shoqërisë mëmë	118	-	-	-
		<b>1,285,709</b>	<b>24,716</b>	<b>492,100</b>	<b>12,619</b>

### Kompensimi i drejtimit kyç

Drejtimi kyç përfshin drejtorët ekzekutivë të Shoqërisë. Kompensimi për Drejtimi kyç përfshin përfitimet afatshkurtra për Z. Selim Sevgen, Z. Youngian Xu dhe Z. Mustafa Nezir Kubac.

Nuk ka përfitime pas punësimit, përfitime të tjera afatgjata, përfitime ndërprerjeje dhe pagesa të bazuara në aksione, përveç pagës.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Pagat dhe shpërblimet	26,184	24,101
Kontributet në fondin e pensioneve	1,901	1,817
<b>Totali</b>	<b>28,085</b>	<b>25,918</b>



Beralb sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

### 31. Manaxhimi i riskut financiar

Aktiviteti i Shoqërisë e ekspozon atë ndaj një sërë rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun nga kurset e këmbimit, rrezikun e normave të interesit, rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Drejtimi monitoron rrezikun e përgjithshëm dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

Departamenti i Financës menaxhon rrezikun financiar nën mbikëqyrjen e departamentit të financës së Shoqërisë mëmë. Ky departament përcakton dhe vlerëson rreziqet financiare në bashkëpunim të ngushtë me drejtimin. Aktivitetet e lidhura me menaxhimin e rrezikut financiar kanë për qëllim mbulimin e fushave specifike si: rreziku i çmimeve, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kredisë dhe rreziku i likuiditetit.

#### Risku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar të luhetet për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut.

Rreziku i tregut përfshin tre lloje të riskut: rreziku i çmimeve, rreziku i normës së interesit dhe rreziku i monedhës. Instrumentet financiare të ndikuara nga rreziku i tregut përfshijnë huatë dhe huamarrjet, depozitat, llogaritë e arkëtueshme, pagesat e tregtisë, detyrimet e përlllogaritura.

Analizat e ndjeshmërisë janë përgatitur duke marrë në konsideratë që shuma e borxhit neto, raporti i normave fikse të interesit ndaj luhatjeve të borxhit dhe përqindja e instrumenteve financiare në monedhë të huaj janë të gjitha konstante. Analizat e ndjeshmërisë synojnë të ilustrojnë ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve të variablave të tregut në instrumentet financiare të Shoqërisë dhe të tregojnë ndikimin në fitimin ose humbjen dhe kapitalin, ku është e aplikueshme. Analiza përjashton ndikimin e lëvizjeve në variabla të tregut në vlerën e mbartur të provizioneve.

Supozimet e mëposhtme janë bërë në llogaritjen e analizave të ndjeshmërisë:

- Ndjeshmëria në pasqyrën e pozicionit financiar lidhet kryesisht me llogaritë e arkëtueshme tregtare në dollar amerikanë.
- Ndjeshmëria e zërit fitimi përpara tatimit dhe/ose kapitalit është efekti i ndryshimeve të supozuara në rreziqet përkatëse të tregut. Kjo bazohet në asetet financiare dhe detyrimet financiare të mbajtura më 31 dhjetor 2019.
- Ndikimi në kapital është i njëjtë me ndikimin në fitimin para tatimit.


#### Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

#### Risku i çmimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të luhatjeve në çmimet mbizotëruese të mallrave të tregut të bakrit. Shuma përfundimtare e të ardhurave përcaktohet në bazë të çmimeve të tregut të bakrit gjatë periudhës së kuotimit për çdo transaksion. Shoqëria mëmë menaxhon rrezikun e çmimeve, në nivel grupi, duke mbrojtur rrezikun e luhatjeve në çmimet e tregut të bakrit në treg. Prandaj, Shoqëria nuk është e ekspozuar drejtpërdrejtë ndaj ndonjë marrëveshjeje derivative.

Megjithatë, Shoqëria ka pushuar aktivitetin e saj të nxjerrjes dhe prodhimit që nga viti 2015 si çmimet e bakrit dhe nuk ka pasur të ardhura të gjeneruara dhe ndikuara nga rreziku i çmimeve.



(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 31. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

## Rreziku i Kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Përshkrimi	31 dhjetor 2019			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	352,329	-	-	-
Mjete monetare në arkë dhe bankë	6,944	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>359,273</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>359,273</b>
				<b>Total</b>
				352,329
				6,944
				359,273

Përshkrimi	31 dhjetor 2018			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	134,383	-	-	-
Mjete monetare në arkë dhe bankë	9,151	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>143,534</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>143,534</b>
				<b>Total</b>
				134,383
				9,151
				143,534



(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 31. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

## Rreziku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristikë likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Përshkrimi	31 dhjetor 2019				Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	352,329	-	-	-	352,329
Mjete monetare në arkë dhe bankë	6,944	-	-	-	6,944
<b>Totali</b>	<b>359,273</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>359,273</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(387,701)	(8,903)	-	-	(387,701)
Hua	(58,633)	(8,903)	-	-	(67,536)
<b>Totali</b>	<b>(446,334)</b>	<b>(8,903)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(455,237)</b>
<b>Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(87,061)</b>	<b>(8,903)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(95,964)</b>

Përshkrimi	31 dhjetor 2018				Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	134,383	-	-	-	134,383
Mjete monetare në arkë dhe bankë	9,151	-	-	-	9,151
<b>Totali</b>	<b>143,534</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>143,534</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(277,870)	(83,451)	(62,157)	-	(340,027)
Hua	(82,427)	(83,451)	(67,017)	-	(232,895)
<b>Totali</b>	<b>(360,297)</b>	<b>(83,451)</b>	<b>(129,174)</b>	<b>-</b>	<b>(572,922)</b>
<b>Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(216,763)</b>	<b>(83,451)</b>	<b>(129,174)</b>	<b>-</b>	<b>(429,388)</b>



(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rastere kur cilësohet ndryshe)

## 31. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

## Rreziku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshme dhe të pagueshmeve. Vlera kontabel neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2019		
	EUR	ALL	USD
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	300	222,810	129,219
Mjete monetare në arkë dhe bankë	1,426	1,015	4,503
<b>Totali</b>	<b>1,726</b>	<b>223,825</b>	<b>133,722</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(12,215)	(138,662)	(236,824)
Hua			(67,536)
<b>Totali</b>	<b>(12,215)</b>	<b>(138,662)</b>	<b>(304,360)</b>
<b>Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(10,489)</b>	<b>85,163</b>	<b>(170,638)</b>

Përshkrimi	31 dhjetor 2018		
	EUR	ALL	USD
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	397	132,998	988
Mjete monetare në arkë dhe bankë	1,769	4,814	2,568
<b>Totali</b>	<b>2,166</b>	<b>137,812</b>	<b>3,556</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(22,276)	(134,099)	(183,652)
Hua			(232,895)
<b>Totali</b>	<b>(22,276)</b>	<b>(134,099)</b>	<b>(416,547)</b>
<b>Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(20,110)</b>	<b>3,713</b>	<b>(412,991)</b>



*Beralb sh.a.*

*Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019*

*(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)*

### 32. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

### 33. Angazhime dhe pasiguri

*Zhvlërimi i llogarive të arkëtueshme*

Vlerësimi i shumës së rikuperueshme nga llogaritë e arkëtueshme bëhet kur mbledhja e të gjithë shumës nuk është më e mundur. Për shumë individuale të mëdha, vlerësimi bëhet në baza të veçanta. Shumat të cilat nuk kanë vlerë domethënëse në mënyrë individuale, por që u ka kaluar afati i arkëtimit, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet provizionimi bazuar në kohën e kaluar nga arkëtimi si dhe duke marrë parasysh normën historike të rimarrjeve.

### 34. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlërimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Shoqëria gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijmësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 5 "Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.



A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized initials and a surname.

**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR****Për Menaxhimin dhe ortakun e Shoqërisë Beralb sh.a.****Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Beralb sh.a. (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku Jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Theksim çështje**

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5.1 të pasqyrave financiare, duke theksuar se Shoqëria pësoi humbje neto para taksave për një shumë prej 178,163 mijë lekësh (më 31 Dhjetor 2018: 1,049,954 mijë Lek) dhe në total grumbulloi një humbje prej 5,769,324 mijë Lek (2018: 5,591,162 mijë Lek). Të gjitha këto ngjarje, së bashku me çështje të tjera përcaktuar në shënimin nr. 5.1 të pasqyrave financiare, tregojnë se ekziston një pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë.

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5.2 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare individuale.

Opinionin ynë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

**Çështje të tjera**

Pasqyrat financiare të Beralb sh.a për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, janë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pa modifikuar në datën 17 tetor 2019.

**Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

15 qershor 2020



Diana Ylli (Golemi)  
Auditues Ligjor

 M A Z A R S  
Pr. Emin Duraku, Pall "Bijalberi",  
No.3, 1000, Tirana, Albania  
phone : +355 42 27 80 15  
www.mazars.al , info@mazars.at